



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/86  
Datë: 04.07.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.08-P-053 të datës 13 qershor 2022, jep mendim lidhur me Nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson Nismën Legjislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06L-010 për Noterinë, si nismë e cila është në pajtim me nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-025 për Nismat Legjislative.
3. Ministria e Drejtësisë, në mendimin e saj konstaton se propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë, duke i dhënë të drejtë Ministres së Ministrisë së Drejtësisë, që nëpërmjet Vendimit të autorizoj një noter të licencuar (nga ata aktual), për kryerjen e shërbimeve noteriale në territorin e një komune tjetër, ku për shkak të rrethanave të krijuara ligjore dhe faktike, nuk ka noterë të licencuar dhe se ofrimi dhe kryerja e shërbimeve noteriale për këtë kategori të qytetarëve në këto komuna do të ishte më e lehtë, dhe iniciativa e tillë, do të kontribuonte në avancimin e sistemit juridik në përgjithësi dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve në veçanti, sa i përket shërbimeve noteriale.
4. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve vlerëson se për nga aspekti i ndikimit buxhetor, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-010 për Noterinë nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
5. Ky Vendim së bashku me mendimin e dhënë nga Ministria e Drejtësisë, Opinionin e Departamentit të Buxhetit të MFPT dhe Opinionin ligjor të përputhshmërisë me Acquis të BE-së të Zyrës Ligjore - ZKM, i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë